

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

| | |
|--------------------------------------|---|
| 1. MATERIALE KËRKIMORE | 2 |
| 2. AKTIVITETE KËRKIMORE | 5 |
| 3. LINGJE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA | 9 |

Materiali “Të Rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë” paraqet një përmbledhje të punës kërkimore të Bankës së Shqipërisë në harkun kohor të gjashtë muajve. Ky numër pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1. MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike me në fokus tema që kanë të bëjnë me impaktin e pandemisë dhe masave të marra në klimën ekonomike, modelet ekonomike dhe parashikimet afatshkurtra dhe afatgjata dhe tema specifike mbi sektorin bankar dhe atë të jashtëm. Në mënyrë të përmbledhur, ato paraqiten më poshtë.

“Përdorimi i qasjes së modelit empirik për parashikimin e nevojës afatshkurtër dhe asaj afatgjatë për likuiditet në tregun ndërbankar, në rastin e sektorit financiar shqiptar”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve

Banka e Shqipërisë rregullon nevojën për likuiditet në sektorin financiar në një horizont kohor të zgjedhur, për të pasqyruar qëndrimin e saj të politikës monetare.

Është ky këndvështrim që banka qendrore analizon dhe parashikon kërkesën për likuiditet afatshkurtër dhe afatgjatë në treg, i cili ndryshon si rezultat i ndryshimeve të faktorëve autonomë dhe atyre jo autonomë. Për këtë arsye, ky punim zhvillon një sërë modelesh empirike me të dhëna ditore për periudhën 2008 – 2019, me qëllim parashikimin e nevojës për likuiditet në tregun ndërbankar, duke u mbështetur në tregues binar dhe në përjasjen e ndarjes së likuiditetit sipas faktorëve autonomë dhe atyre diskrecionarë.

“Impakti i mbylljes nga Covid-19 në aktivitetin ekonomik”, nga Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve

Studimi shikon efektin e drejtpërdrejtë të menjëhershëm të mbylljes në aktivitetin ekonomik dhe tregjet e punës. Pavarësisht se këto efekte të menjëhershme mund të mos kapin impaktin total në një horizont të gjatë kohor, vlerësimet ofrojnë një krahasim në peshimin e kostos së “mbylljes” së

ekonomisë kundrejt përfitimeve në drejtim të frenimit të përhapjes së virusit. Gjetjet e studimit sugjerojnë se, bazuar në shkallët e masave të bllokimit të vendosura gjatë valës së parë, ngritja e nivelit të mbylljes së ekonomisë me çdo 10 pikë përqindjeje mund të shkaktojë një rënie të prodhimit industrial me 5% në çdo muaj. Madhësia e ndikimit të “mbylljes” së ekonomisë në nivelin e papunësisë duket shumë e ulët, edhe pse statistikisht e rëndësishme. Vlerësimet tregojnë se mbyllja e ekonomisë mund të ndikojë më shumë në punësimin në industrinë e ndërtimit dhe të shërbimeve, ndërsa punësimi në bujqësi dhe prodhim mund të vuajë relativisht më pak. Për më tepër, papunësia midis të rinjve mund të rritet më shpejt sesa papunësia në mesin e popullatës së moshuar, për shkak të masave të “mbylljes” së ekonomisë.

“Ndikimi i investimeve të huaja direkte në uljen e varfërisë në Ballkanin Perëndimor”, nga Margerita Topalli dhe Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Punimi studion empirikisht ndikimin e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte (IHD) në nivelin e varfërisë në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, duke marrë në konsideratë gjithashtu edhe karakteristika të tjera të këtyre vendeve, të tilla si: indeksi i zhvillimit njerëzor, korrupsioni, liria e investimeve, liria ekonomike, hapja e tregtisë dhe fertiliteti. Ai paraqet vlerësime të bazuara në metodën e përgjithësuar të momenteve për modelet e të dhënave panel me efekte fikse, përgjatë periudhës 2002-2018. Rezultatet empirike tregojnë se IHD-të kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në uljen e varfërisë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, vëmendje duhet t'i kushtohet faktit që këto investime të orientohen drejt sektorëve më produktivë të ekonomisë, duke ndikuar në këtë mënyrë në një ulje më të madhe të varfërisë dhe pabarazisë së të ardhurave. Studimi gjen gjithashtu se politikat dhe institucionet që mbështesin lirinë ekonomike dhe hapjen e një vendi janë të domosdoshme për zbutjen e varfërisë. Përveç këtyre, ulja e varfërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të arrihet përmes masave që kontribuojnë në përmirësimin e indeksit të zhvillimit njerëzor dhe forcimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin.

“Parashikimi përmes një modeli VAR Bajezian me parametra të ndryshueshëm: evidenca nga ekonomia shqiptare”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Ky studim synon të analizojë nëse përdorimi i parametrave të ndryshueshëm në kohë sjell ndonjë përmirësim të dukshëm në saktësinë e parashikimit të treguesve kryesorë të ekonomisë shqiptare. Duke përdorur të dhëna për periudhën 2000-2019, është ndërtuar një model Bayesian VAR me koeficientë të ndryshueshëm, vlerësuar me metodën Monte Carlo (MCMC), i cili përfshin këta tregues: produktin e brendshëm bruto, indeksin e çmimeve të konsumit dhe normën e interesit të bonove 12-mujore. Në vazhdim, performanca parashikuese e këtij modeli është krahasuar me modele të tjera ekonometrike më të thjeshtuara të tilla si: ARIMA dhe VAR. Rezultatet tregojnë se modeli BVAR me parametra të ndryshueshëm është superior ndaj dy modeleve të tjera përgjatë horizonteve të ndryshme parashikuese të periudhës së marrë në shqyrtim.

1.2. MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

“Vrojtimi i Pasurisë së Familjeve Shqiptare: Rezultatet e Valës së Parë”, Elona Dushku, Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve

Ky raport përmbledh fakte kryesore të stilizuara nga vala e parë e Vrojtimin të Pasurisë së Familjeve Shqiptare, të realizuara nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2019. Qëllimi i këtij vrojtimi është të mbledhë të dhënat individuale mbi pasurinë reale dhe financiare të 2500 familjeve shqiptare. Raporti paraqet rezultatet mbi pasurinë e familjes (reale dhe financiare), detyrimet, të ardhurat dhe treguesit e konsumit, bazuar në grupe të ndryshme familjesh. Rezultatet e valës së parë tregojnë se pasuria e familjes përbëhet kryesisht në formën e pasurive reale, ku vendbanimi kryesor i familjeve është komponenti më i rëndësishëm i pasurisë së familjes. Ndërsa pasuritë financiare përbëjnë një pjesë të vogël të aktiveve totale të familjeve. Për më tepër, të dhënat sugjerojnë një sjellje tepër heterogjene të familjeve shqiptare bazuar në tregues të ndryshëm të bilancit të ekonomive familjare.

“Vrojtimi për matjen e kulturës financiare: Analiza e rezultateve për Shqipërinë, 2019”, nga Arlinda Koleniço, Kliti Ceca dhe Egnis Isaku, Departamenti i Kërkimeve

Banka e Shqipërisë ka kryer për herë të tretë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave që lidhen me nivelin e kulturës financiare të popullatës në Shqipëri. Anketa “Kultura Financiare në Shqipëri” bazohet në direktivat dhe metodologjinë e OECD/ INFE dhe u realizua në bashkëpunim me INSTAT-in në muajt shtator-tetor 2019. Të dhënat e marra nga kjo anketë përbëjnë një informacion të

rëndësishëm për identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për vëmendje dhe ndërhyrje, përmes projekteve të edukimit financiar nga ana e Bankës së Shqipërisë.

“Përcaktuesit e euroizimit të depozitave: disa dëshmi për Shqipërinë”, nga Denada Rada, Departamenti i Kërkimeve

Materiali studimor ka për qëllim të analizojë natyrën e depozitave në Euro në Shqipëri dhe të zbërthejë faktorët të cilët kanë kontribuar në trendin e tyre rritës të viteve të fundit. Vlerësimi empirik bazohet mbi një model VECM me këto tregues: depozitat në Euro në sistemin bankar, fluksi i të ardhurave nga emigrantët, kursi nominal i këmbimit, shkalla e zhvillimit të sistemit financiar dhe diferenca në normën e interesit të depozitave në monedhë vendase dhe asaj të huaj, për periudhën kohore 2008-2020. Rezultatet paraprake sugjerojnë se zhvillimi financiar rritet në prani të depozitave në Euro. Gjithashtu, zhvillime pozitive në diferencën mes normave të interesit dhe kursit nominal të këmbimit kanë tendencën të shtojnë depozituesit drejt kursimeve në monedhën vendase.

“Lidhja midis papunësisë dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, si dhe ndikimi i Covid-19”, nga Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve

Ky studim analizon lidhjen midis ndryshimit në papunësi dhe rritjes ekonomike, parë në kuadër të ligjit të Okun-it. Gjithashtu, është parë nëse rënia e aktivitetit ekonomik si rezultat i Covid-19, ka ndikuar në papunësi. Në terma të metodologjisë, studimi përdor një model VAR dhe treguesit “flow” të tregut të punës. Gjetjet tregojnë se rënia e rritjes së prodhimit, ndikon në rritjen e shkallës së papunësisë në vend.

1.3. ARTIKUJ KËRKIMORË

ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE

“Izolimi i madh: përgjigja e politikave ndaj pandemisë dhe kushtet e kredisë bankare”, nga Carlo Altavilla, Francesca Barbiero, Miguel Boucinha, Lorenzo Burlon, Banka Qendrore Evropiane

Ky studim analizon politikat e ndërmarra në Eurozonë, në përgjigje të shpërthimit dhe përhapjes së përshkallëzuar të pandemisë së re të koronavirusit (COVID-19). Autorët përqendrohen në politikat monetare, mikroprudenciale dhe makroprudenciale të hartuara posaçërisht për të mbështetur kushtet e kredihënies bankare. Më konkretisht, autorët përdorin të dhëna mbi pjesëmarrjen në operacionet e likuiditetit të bankës qendrore, reagimet me frekuencë të lartë ndaj njoftimeve të politikës monetare dhe informacionet konfidenciale të mbikëqyrjes së kërkesave e kapitalit bankar. Rezultatet sugjerojnë se, në mungesë të lehtësimit të kostos së financimit dhe lehtësimit të kapitalit të shoqëruar me masat e reagimit ndaj pandemisë, aftësia e bankave për të dhënë kredi do të ishte prekur rëndë. Rezultatet gjithashtu tregojnë se ndërhyrja e koordinuar nga autoritetet monetare dhe makroprudenciale amplifikoi efektet e masave individuale për mbështetjen e likuiditetit dhe duke mbështetur rrjedhën e kredisë në sektorin privat. Së fundmi, autorët hetojnë efektet e mundshme reale të masave të përbashkëta të reagimit ndaj pandemisë, duke gjetur se, në mungesë të politikave monetare dhe makroprudenciale, pandemia do të çonte në një rënie dukshëm më të madhe të punësimit në sektorin privat.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/>

“Çfarë vjen më pas?”, nga Daniel Rees, BIS

Kriza e Covid-19 nxiti një turrje ekonomike globale të paprecedentë. Edhe pse më e keqja ka të ngjarë të mbetet pas, është e mundur që rimëkëmbja të jetë jo e njëtrajtshme, ku aktiviteti ekonomik në shumë industri shërbimi do të mbetet i kufizuar edhe për disa kohë. Autori përdor një model kuantitativ me shumë industri për të vlerësuar forcat ekonomike që shpjegojnë rënien e aktivitetit ekonomik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Eurozonë, Japoni dhe Kinë, në gjysmën e parë të vitit 2020. Ai përdor të njëjtin model për të projektuar trajektoren e rimëkëmbjes së ekonomisë, duke konstatuar se SHBA-ja, Eurozona dhe Japonia do të përballen me një “ekonomi 98%”, nëse gjysma e kufizimeve të vendosura për industrinë e shërbimeve gjatë gjysmës së parë 2020 do të vijojnë. Rimëkëmbja ekonomike në Kinë parashikohet të ndodhë më shpejt.

<https://www.bis.org/publ/work898.htm>

“A do të sjellë Pandemia Covid-19 një rishpërndarje të vendeve të punës dhe persistencë të papunësisë?”, nga Joel David, Rezerva Federale

Pandemia Covid-19 ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në ekonominë e SHBA-së. Efektet nuk kanë qenë më të rënda sesa në tregun e punës; në një hark kohor prej vetëm dy muajsh, niveli i papunësisë u rrit nga 3.5% në shkurt 2020, në 14.7% në prill - një nivel ky që nuk ishte hasur që nga periudha e Depresionit të Madh - para se të binte lehtësisht në muajt maj dhe qershor. Sa të qëndrueshme ka të ngjarë të jenë këto efekte? A do të rimëkëmbet shpejt tregu i punës pasi të hiqen plotësisht kufizimet e lidhura me pandeminë apo papunësia

do të mbetet në nivele të larta edhe në të ardhmen?

<https://www.chicagofed.org/publications/chicago-fed-letter/2020/444>

“Paraja helikopter në Evropë: Dëshmi të reja mbi prirjen marginale konsum në familjet evropiane”, nga Katharina Drescher, Pirmin Fessler, Peter Lindner, Banka e Austrisë

Përhapja e fundit e COVID-19 ka sjellë krizën më të fortë ekonomike që nga vitet 1930. Për të rritur kërkesën pas krizës, po diskutohet aplikimi i transfertave direkte monetare drejt familjeve. Duke përdorur të dhëna mikro nga Anketa e Financave dhe Konsumit të Familjeve të Eurosishtimit (HFCS), autorët studiojmë se ç’pjesë të këtyre transfertave do të shpenzonin në të vërtetë familjet. Autorët shfrytëzojnë faktin se në pyetësorin e valës së fundit të studimit është përfshirë një pyetje eksperimentale për të llogaritur prirjen marginale për konsum nga fitime hipotetike të papritura që mund të ketë familja. Rezultatet tregojnë se familjet mesatarisht shpenzojnë ndërmjet rreth 33% (Hollandë) dhe 57% (Lituanë) të një transferte të tillë.

<https://www.oenb.at/en/Publications/Economics/Working-Papers.html>

“Të dhënat përkundrejt kolateralit”, nga Leonardo Gambacorta, Yiping Huang, Zhenhua Li, Han Qiu, Shu Chen, BIS

Përdorimi i të dhënave masive nga firmat e mëdha të teknologjisë (Big Tech) për të vlerësuar aftësinë kreditore të firmave, mund të zvogëlojë nevojën për të përdorur kolateralin si mjet për zgjidhjen e problemeve të informacionit asimetrik në tregjet e kredisë. Duke përdorur një databazë të dhënash unike me më shumë se 2 milion firma kineze të cilat morën kredi si nga një firmë e rëndësishme Big Tech (Ant Group) ashtu edhe nga bankat tregtare, ky material analizon sesi forma të ndryshme të kredisë lidhen me aktivitetin ekonomik lokal, çmimet e shtëpive dhe karakteristikat e firmës. Autorët gjejnë se kredia e Big Tech nuk reagon ndaj aktivitetit ekonomik dhe ndaj çmimeve të shtëpive, por reagon fort ndaj ndryshimeve në karakteristikat e firmës, të tilla si vëllimet e transaksioneve dhe sistemi i pikësimit të përdorura për të llogaritur aftësinë kreditore të firmës. Kjo gjetje nënkupton se një përdorim më i gjerë i kredisë nga Big Tech - i shpërndarë në bazë të teknologjisë dhe Big Data - mund të zvogëlojë rëndësinë e kolateralit në tregjet e kredisë dhe potencialisht të dobësojë mekanizmin e përshpejtuesit financiar.

<https://www.bis.org/publ/work881.htm>

2. AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 SEMINARE TEKNIKE

“Përdorimi i qasjes së modelit empirik për parashikimin e nevojës afatshkurtër dhe asaj afatgjatë për likuiditet në tregun ndërbankar, në rastin e sektorit financiar shqiptar”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve

Ky studim i prezantuar përmes platformave

online të mundësuar pranë Bankës së Shqipërisë, ka për qëllim të zhvillojë një sërë modelesh empirike me të dhëna ditore për periudhën 2008 – 2019, me qëllim parashikimin e nevojës për likuiditet në tregun ndërbankar, duke u mbështetur në tregues binarë dhe në përjasjen e ndarjes së likuiditetit sipas faktorëve autonomë dhe atyre diskrecionarë.

2.2 AKTIVITETE TË TJERA

“Aktivitete trajnuese të stafit të Departamentit të Kërkimeve, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Programin e Asistencës Dypalëshe për Ngritjen e Kapaciteteve për Bankat Qendrore (BCC)”, online, Banka e Shqipërisë

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Programin e Asistencës Dypalëshe për Ngritjen e Kapaciteteve për Bankat Qendrore (BCC), në datat 21-25 shtator, u organizua aktiviteti trajnues online ***“Hyrje në programin R dhe përdorimi i tij për qëllime të modelimit ekonomik” me lektor Dr. Seton Leonard.*** Aktiviteti synonte të njëjtte punonjësit me programin kompjuterik R, i cili ofron një tërësi funksionesh shtesë mjaft të dobishme për qëllime analizash ekonometrike dhe parashikime. Përveç këtij aktiviteti, një tjetër kurs trajnues me temë ***“Modele të avancuara parashikuese”, me lektor Dr. Massimiliano Marcellino,*** u zhvillua online, në datat 10-13 nëntor. Ai synonte të thellonte më tej njohuritë e punonjësve mbi metodat e avancuara ekonometrike që përdoren për qëllime parashikimi, në përputhje me teknikat që përdoren sot nga bankat qendrore.

2.3 TAKIMI I 14-TË RAJONAL KËRKIMOR NË EVROPËN JUGLINDORE

Në datat 10-11 dhjetor 2020, Departamenti i Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë organizoi takimin e 14-të të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, me qëllim mbështetjen dhe promovimin e kërkimit ekonomik, si dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, por dhe më gjerë, në fushat e

bankingut qendror. Ky aktivitet i përvitshëm, këtë vit u organizua online, në kushtet e distancimit social, si pasojë e pandemisë COVID-19. Pavarësisht kësaj, aktiviteti ia arriti qëllimit për të shërbyer si një platformë për të rritur bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore dhe më gjerë, në rritjen e kontributit potencial të bankës qendrore në tregjet financiare, në ekonomi dhe në shoqëri.

Gjatë dy ditëve intensive të punimeve të këtij seminari, kërkuesit shkencorë prezantuan studimet e tyre mbi tematikat ekonomiko-financiare, si më poshtë:

- *Pandemia Covid-19 dhe impakti i saj në klimën ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare;*
- *Politikat ekonomike jokonvencionale, në kuadër të zhvillimeve ekonomike të viteve të fundit;*
- *Aspekte teorike dhe empirike të politikës monetare dhe politikës makroprudenciale;*
- *Modele makroekonomike për analizën e politikave dhe parashikimet;*
- *Përfitueshmëria e sistemit bankar, struktura e financimit dhe huamarrja;*
- *Eurozimi dhe çështje të tjera specifike për vendet e CESEEE (Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore);*
- *Të dhënat mikro dhe përdorimi i tyre në analizat empirike në bankat qendrore.*

Punimet e prezantuara gjatë këtij aktiviteti do t'i gjeni të detajuara si më poshtë:

- *“Lëvizshmëria dhe kufizimet e qeverisë në kuadër të Covid-19”, Ines Buono, Francesco Paolo Conteduca, (Banka e Italisë);*
- *“Efektet ekonomike të Covid-19”, Bledar Hoda (Banka e Shqipërisë);*
- *“Vrojtimi i Pasurisë së Familjeve Shqiptare:*

- Rezultatet e Valës së Parë”, Elona Dushku, Ola Çami (Banka e Shqipërisë);
- “Politikat monetare jokonvencionale dhe pritjet mbi variablat ekonomike”, Alessio Anzuini, Luca Rossi, (Banka e Italisë);
 - “Vlerësimi i efektivitetit të politikës monetare në Maqedoninë e Veriut: dëshmi nga një kornizë Bayesian FAVAR”, Artan Sulejmani, (Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut);
 - “Kërkesa për para dhe ndjeshmëria e interesit në Indi: një qasje ARDL”, Masudul Hasan, Adil Refig Hussain, Adelajda Matuka (Universiti i Mumbai & Universiti i Makerata);
 - “Trilema nën zgjedhën e paradigmës së Valutës Dominuese?”, Vanesa Olakemi, (Universiteti i Orleansit);
 - “Keqëpërfaqësimi i kolateralit, auditimi i jashtëm dhe politikat optimale monetare dhe mbikëqyrëse”, Fatih Tuluk, (University i Qipros së Veriut);
 - “Kur mund të jenë në konflikt politikat makroprudenciale dhe monetare?”, Jose D. Garcia, Grégory Levieuge, (Universiteti i Orleansit);
 - “Prevalenca dhe përcaktuesit e huamarrjes jobankare në CESEE: dëshmi nga Eurosurvey i OeNB”, Katharina Allinger, Elisabeth Beckmann, (Banka e Austrisë);
 - “Lidhjet financiare ndërsektoriale në Indonezi gjatë pandemisë së hershme Covid-19”, Agni Alam Awirya, Fazal Rahman, (Banka e Indonezisë);
 - “Përcaktuesit e përfitueshmërisë të bankave tregtare në rajonin e Evropës Juglindore: një qasje GMM”, Francesco Guidi, Enowbi Batwo Michael (Universiteti i Greenwich);
 - “Bankat e huaja vs lokale në vendet e CESEE: Një analizë e ndikimit të strukturës së financimit në kanalin e kredisë”, Olta Manjani, (Banka e Shqipërisë);
 - “Spillovers nga politikat prudenciale të zbatuara në nivel të konsoliduar: Dëshmi nga ushtrimi mbi kapitalin e EBA-së 2011 dhe efekti i tij në Slloveni”, Selcuk Ozsahin, (Banka e Sllovenisë);
 - “Hendeku i kredisë ndaj PBB-së: kreditë në valutën vendase kundrejt valutës së huaj”, Gjergj Legisi, (Banka e Shqipërisë);
 - “Vlerësimi i parashikimeve të normave të interesit në Bankën e Shqipërisë gjatë procesit të alokimit të asetëve”, Doriana Dine, Rezart Erindi, (Banka e Shqipërisë);
 - “Parashikimi i serive kohore shqiptare me modele lineare dhe jolineare univariate?”, Blerina Vika, Ilir Vika, (Banka e Shqipërisë);
 - “Përdorimi i qasjes së modelit empirik për parashikimin e nevojës afatshkurtër dhe asaj afatgjatë për likuiditet në tregun ndërbankar, në rastin e sektorit financiar shqiptar”, Gerti Shijaku, (Banka e Shqipërisë);
 - “Parashikimi përmes një modeli VAR Bajezian me parametra të ndryshueshëm: evidenca nga ekonomia shqiptare”, Meri Papavangjeli, (Banka e Shqipërisë);
 - “Normat e interesit në tregjet në zhvillim, rezervat ndërkombëtare dhe asetet e huaja neto”, Joseph Bitar, (Universiti i Lille);
 - “Ndikimi i investimeve të huaja direkte në uljen e varfërisë në Ballkanin Perëndimor”, Meri Papavangjeli, Margerita Topalli, (Banka e Shqipërisë);
 - “Analiza e marrëdhënies midis nivelit të papunësisë dhe rritjes së outputit”, Orion Garo, (Banka e Shqipërisë);
 - “Përcaktuesit e euroizimit të depozitave: disa dëshmi për Shqipërinë”, Denada Rada, (Banka e Shqipërisë);

2.4 ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2020

Banka e Shqipërisë, në kuadër të inkurajimit të studentëve të ekonomisë si brenda dhe jashtë vendit, për t'u angazhuar në punë cilësore kërkimore shkencore në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe financës, edhe gjatë vitit 2020, organizoi konkursin e hapur të "Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të mirë". Në këtë konkurs morën pjesë studentë nga universitetet brenda dhe jashtë vendit, me tematika të lidhura me ekonomiksin monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar etj. Në kuadër të masave të distancimit social, këtë vit shpërndarja e çmimeve u zhvillua online.

Me çmimin e parë u vlerësua zj. Megi Jaupi, studente në Universitetin e Zyrihut ETH, Zvicër, me temën "Rrjetet gjeneruese të kundërshtimit për simulimin e kthimit me shumë variabla dhe optimizimit të qëndrueshëm të portofolit". Kjo temë aplikon metodologjinë e rrjeteve neurale, si një nga metodat më interesante dhe më të sofistikuar, të aplikuara së fundmi dhe nga shumë banka qendrore në botë, për përafrimin e shpërndarjeve shumëdimensionale të variablave të rastit në studimin e ekonomisë. Studimi u vlerësua jo vetëm për përjasjen metodologjike, por edhe për trajtimin e tij të plotë në aspektin e shkërimit akademik.

Me çmimin e dytë u vlerësua z. Argi Hanku, student në Universitetin e Vjenës, Austri, me temën "Vlerësimi i përfaqësuesve të likuiditetit me frekuencë të ulët". Fokusi i temës mbi karakteristikat e likuiditetit sjell në këtë konkurs një këndvështrim të ri të pa trajtuar në aplikimet e mëparshme në këtë konkurs. Likuiditeti i investimeve është një aspekt shumë i rëndësishëm dhe merr një vëmendje të veçantë në fushën e operacioneve monetare nga këndvështrimi i mirëadministrimit të rezervës valutore. Gjithashtu, ai është një element i rëndësishëm i sjelljes investuese, veçanërisht gjatë dhe pas periudhave të krizave financiare e ekonomike.

Me çmimin e tretë u vlerësua zj. Eda Meta, studente në Universitetin "Berlin School of Economics and Law", Gjermani, me temën "Vlerësimi i ndikimit të obligacioneve CoCo në banka". Materiali prezanton dhe përshkruan natyrën, qëllimin dhe strukturën e këtyre instrumenteve në sfondin e krizës financiare dhe ndryshimin e standardeve ndërkombëtare të Bazelit, drejt Bazeli III. Pavarësisht se në rastin e Shqipërisë, obligacionet CoCo (Contingent Convertible Bonds), nuk janë ende realitet, është me vlerë që këto risi të diskutohen dhe të njihen si mundësi apo alternativë qoftë edhe në nivel akademik. Ky material kërkimor mbështetet në vlerësimin e ndikimit dhe efektivitetit të obligacioneve CoCo mbi aftësinë paguese të bankës, si një instrument për absorbimin e humbjeve.

3.LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:**Banca d'Italia**

<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

<http://www.cnb.cz/en/research/>

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

http://www.ecb.int/home/html/researcher_en.html

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp

